



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 102, datë 31.08.2021

**MBI**

**MIRATIMIN PËR PRISHJEN E DETYRUAR TË GODINËS 2KT, QË I PËRKET SHKOLLËS 9-VJEÇARE VARDARDHË, NJËSIA ADMINISTRATIVE SUKTH, BASHKIA DURRËS, QË MBAN NR. 07, TË LISTËS SË TRANSFERIMIT, QË ME VKM NR. 297, DATË 28.04.20210 BËN PJESË NË LISTËN PARAPRAKE TË PRONAVE TË ISH BASHKISË SUKTH (SOT BASHKIA DURRËS), PËR SHKAK SE ËSHTË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E DATËS 26 NËNTOR 2019 DHE PËRBËN RREZIK PËR JETËN DHE SHËNDETIN, DHE REKOMANDOHET TË DEMOLOHET, KJO SIPAS AKTEKSPERTIZËS SË THELLUAR, REALIZUAR NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT TIRANË, DHE MIRATIMIN PËR HEQJEN NGA KONTABILITETI DHE LISTA PARAPRAKE E PRONAVE, TË GODINËS ME EMËRTIMIN SHKOLLA 9-VJEÇARE VARDARDHË, ME VENDODHJE NJËSIA ADMINISTRATIVE SUKTH, QË ME VKM NR. 297, DATË 28.04.20210, BËN PJESË NË LISTËN PARAPRAKE TË PRONAVE TË ISH BASHKISË SUKTH (SOT BASHKIA DURRËS)**

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM-së nr. 297, datë 28.04.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Sukth”, VKM-së nr.796, datë 11.12.2019 “Për një ndryshim në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, VKM-së nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, shkresës nr.371/5 prot., datë 12.07.2021,

ardhur nga Instituti i Ndërtimit Tiranë, me lëndë “Dërgim Akt ekspertizave të thelluara”, ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike dhe Drejtoria Ligjore, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

## KËSHILLI BASHKIAK V E N D O S I :

1. Miratimin për prishjen e detyruar të godinës 2 KT, që i përket Shkollës 9-vjeçare Vardardhë, Njësia Administrative Sukth, që mban nr. 07 të listës së transferimit, që me VKM nr.297, datë 28.04.2010, bën pjesë e listën paraprake të pronave që transferohen në pronësi të ish Bashkisë Sukth ( sot Bashkia Durrës), për shkak se është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e datës 26 Nëntor 2019 dhe është rekomanduar të demolohet, sipas aktekspertizës së thelluar, realizuar nga Instituti i Ndërtimit Tiranë.
2. Miratimin për heqjen nga lista paraprake të pronës me emërtimin Shkolla 9-vjeçare Vardardhë, që mban nr. 07 të listës së transferimit, që me VKM nr. 297, datë 28.04.2010, bën pjesë në listën paraprake të pronave të ish Bashkisë Sukth ( sot Bashkia Durrës).
3. Drejtoria Ekonomike dhe Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, në zbatim të ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, të kryejnë veprimet në librat e inventarit ekonomik, përditësimin e listës së pronave të paluajtshme dhe fshirjen në regjistrat e pasurive të paluajtshme Durrës, të pronës me emërtimin Shkolla 9-vjeçare Vardardhë, që mban nr.07 të listës së transferimit, që me VKM nr. 297, datë 28.04.2010, bën pjesë në listën paraprake të transferimit.
4. Toka (trualli), i liruar nga prishja e godinës, e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, nëse i plotëson kushtet për rindërtim (pasi të studiohet për kushtet gjeologjike dhe sizmike), të përdoret për rindërtimin e godinës, e dëmtuar nga fatkeqësia natyrore.
5. Shpenzimet për shembjen e godinës, e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të mbulohet nga Inspektoriati Mbrojtjes Territorit Vendor, Bashkia Durrës.
6. Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Vendore, që bazuar në Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të bashkërendojnë punën me Njësinë Zbatuese, që administrojnë fondet për rindërtim, që transferohen nga

Këshilli i Ministrave, prej fondit të rindërtimit, për të realizuar rindërtimin e objektit me emërtimin Shkolla 9-vjeçare Vardardhë, si dhe përfshirjen në listën e inventarit dhe dokumentacionin përkatës të ndërtesës, pas realizimit të rindërtimit.

7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Vendore dhe Drejtoria Ligjore.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 31.08.2021**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 671/5 prot.

Durrës, më 07 . 07 .2021

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.102 datë 31.08.2021 Mbi miratimin për prishjen e detyruar të godinës 2kt, që i përket shkollës 9-vjeçare Vardardhë, Njësia Administrative Sukth, Bashkia Durrës, që mban nr. 07, të listës së transferimit, që me VKM Nr. 297, datë 28.04.20210 bën pjesë në listën paraprake të pronave të ish Bashkisë Sukth (sot Bashkia Durrës), për shkak se është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e datës 26 nëntor 2019 dhe përbën rrezik për jetën dhe shëndetin, dhe rekomandohet të demolohet, kjo sipas aktekspertizës së thelluar, realizuar nga Instituti i Ndërtimit Tiranë, dhe miratimin për heqjen nga kontabiliteti dhe lista paraprake e pronave, të godinës me emërtimin shkolla 9-vjeçare Vardardhë, me vendodhje njësia administrative Sukth, që me VKM Nr. 297, datë 28.04.20210, bën pjesë në listën paraprake të pronave të ish Bashkisë Sukth (sot Bashkia Durrës).

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**ROLAND NASTO**

